INCA
INSTITUTE FOR NATURE CONSERVATION IN ALBANIA

RRJETI PËR MBROJTJEN E NATYRËS

Ditari Natyrës

Nr. 32 Viti i katërt i botimit Janar 2016

Në këtë numër do të gjeni:

- ... me këtë rast Ju kujtojmë se ...
- Festohet Dita e Verës në Parkun Kombëtar të Prespës
- Rehabilitohet moli në gjirin e Shën Vasilit/PKD Karaburun-Sazan
- Prezantohen Planet e Bisnesit dhe Turismit për PKD Karaburun-Sazan
- Fushatë mjedisore ndërgjeqjësuese
- Njoftime

INCA
INSTITUTE FOR NATURE CONSERVATION IN ALBANIA

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri i uron Gëzuar Festat e fund vitit të gjithë lexuesve, miqve, kolegëve, bashkëpunëtorëve dhe dashamirësve duke i falenderuar për mbështetjen e vazhdueshme dhe bashkëpunimin e frytshëm në fushën e ruajtjes së natyrës dhe mjedisit në vendin tonë.

Ne kemi bindjen që Viti i Ri 2016 do të sjellë më shumë bashkëpunime, angazhime e përpjekje në realizimin e qëllimit tonë të përbashkët, ruajtjen e natyrës shqiptare dhe krijimi i një mjedisi sa më të qëndrueshëm për sot dhe brezat që do të vijnë.

Organizatat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës

Adriatiku · GreenClean · PSEDA - ILIRIA · Shoqata Mjedisore Cajupi, Bashkejeto me Natyrën

... me këtë rast Ju kujtojmë se 20 vjet më parë ...

Me VKM Nr. 102, datë 15.01.1996 "Për miratimin në parim të strategjisë për zbatimin e projektit për vlerësimin mjedisor nga zbatimi i projektit të pyjeve (aneksi Rrjeti i Zonave të Mbrojtura)", pas studimit ekologjik të pyjeve të virgjër të Shqipërisë, u miratuan:

1. Rezervat Strikt Natyror

1.Lumi i Gashit, me sipërfaqe 3,000.0 ha, qarku Kukës, rrethi Tropojë.

2.Kardhiqi, me sipërfaqe 1,800.0 ha, qarku Gjirokastër, rrethi Gjirokastër.

3.Laguna e Karavastasë, me sipërfaqe 5,000.0 ha, qarku Fier, rrethi Lushnjë, më pas u përfshi në sipërfaqen e zgjeruar të PK "Divjakë-Karavasta".

4.Rrajca, me sipërfaqe 4,700.0 ha, qarku Elbasan, rrethi Librazhd, më pas u përfshi në sipërfaqen e PK "Shebenik-Jabllanicë".

2. Park Kombëtar

1.Lugina e Valbonës, me sipërfaqe 8,000.0 ha, qarku Kukës, rrethi Tropojë.

2.Mali i Tomorrit, me sipërfaqe 4,000.0 ha, qarku Berat, rrethi Berat, më pas u përfshi në sipërfaqen e PK "Mali i Tomorrit".

3.Bredhi i Hotovës, me sipërfaqe 1,200.0 ha, qarku Gjirokastër, rrethi Përmet, më pas u përfshi në sipërfaqen e PK "Bredhi i Hotovës-Dangëlli".

4.Qafë Shtama, me sipërfaqe 2,000.0 ha, qarku Durrës, rrethi Krujë.

5.Zall Gjocaj 140 ha

3. Monument Natyre

1.Bredhi i Sotirës, me sipërfaqe 1,740.0 ha, qarku Gjirokastër, rrethi Gjirokastër.

2.Zhej, me sipërfaqe 1,500.0 ha, qarku Gjirokastër, rrethi Gjirokastër.

3.Syri i Kaltër, me sipërfaqe 180.0 ha, qarku Vlorë, rrethi Delvinë.

4.Vlashaj, me sipërfaqe 50.0 ha, qarku Dibër, rrethi Peshkopi.

4. Rezervat Natyror i Menaxhuar

1.Rrëzoma, me sipërfaqe 1,490.0 ha, qarku Vlorë, rrethi Delvinë.

2.Tej Drini i Bardhë, me sipërfaqe 30.0 ha, qarku Kukës, rrethi Has.

3.Gërmenj-Shelegur, me sipërfaqe 430.0 ha, qarku Korçë, rrethi Kolonjë.

4.Polis, me sipërfaqe 45.0 ha, qarku Elbasan, rrethi Librazhd.

5.Stravaj, me sipërfaqe 400.0 ha, qarku Elbasan, rrethi Librazhd.

6.Sopot, me sipërfaqe 300.0 ha, qarku Elbasan, rrethiLibrazhd.

7.Dardhë-Xhyrë, me sipërfaqe 400.0 ha, qarku Elbasan, rrethi Librazhd.

8. Qarrishtë, me sipërfaqe 318 ha, qarku Elbasan, rrethi Librazhd.

5. Peizazhi Mbrojtur

1. Nikolicë, me sipërfaqe 510.0 ha, qarku Korçë, rrethi Devoll.

2. Bizë, me sipërfaqe 1370 ha, qarku Tiranë, rrethi Tiranë, më pas përfshihet në PM "Mali me Gropa-Bizë-Martanesh".

3. Berdheti, me sipërfaqe 670 ha, qarku Tiranë, rrethi Tiranë, më pas përfshihet në PM "Mali me Gropa-Bizë-Martanesh".

6. Zonë e Mbrojtur e Burimeve Natyrore të Menaxhuara

1.Luzni-Bulaç, me sipërfaqe 5,900.0 ha, qarku Dibër, rrethi Peshkopi e Bulqizë.

2.Piska-Shqeri, me sipërfaqe 5,400.0 ha, qarku Korçë, rrethi Kolonjë.

3.Bjeshka e Oroshit, me sipërfaqe 4.745.0 ha, qarku Lezhë, rrethi Mirditë.

4.Guri i Nikës, me sipërfaqe 2,000.0 ha, qarku Korçë, rrethi Pogradec.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), me strukturat e vartësisë, ka detyrë dhe duhet të drejtojnë vëmendjen dhe të jetë më e kujdesshme në evidentimin dhe marrjen e masave për njohjen, ruajtjen dhe mirëmenaxhimni e këtyre pasurive me vlerë të lënë në harresë dhe shumë pak të njohur për vendin tonë.

Festohet Dita e Verës në Parkun Kombëtar Prespë

Goricë e Vogël, Prespë, 4 Dhjetor 2015 - Në kuadër të promovimit të Zonave të Mbrojtura dhe vlerave të tyre turistike të lidhura me natyrën dhe produktet lokale, organizata Green&Clean në bashkëpunim me INCA, Rrjetin për Mbrojtjen e Natyrës dhe institucionet lokale, organizuan më 4 Dhjetor në fashtin Goricë të Vogël "Festën e Verës".

Festimi i këtij rituali lokal tashmë është shndërruar në një festim tradicional në zonën e Prespës, e cila është realizuar tre vitet e fundit me mbeshtejen e programi SENiOR-A, financuar nga qeveria Suedeze

dhe mbështetur nga REC. Kjo festë realizohet për të promovuar nëpërmjet shoqërisë civile dhe sjellë në vëmendjen e turistëve, por edhe autoriteteve, vlerat kulturore dhe mbi të gjitha natyrore që ofron kjo zonë për turizmin. Të pranishëm në aktivitete ishin Prefekti i Qarkut Korçë z.Ardit Konomi, Drejtori i AKZM z.Zamir Dedej, Kryetaria e Këshillit të

Qarkut Korçë znj.Ana Verushi, Presidenti i INCA z.Genti Kromidha, përfaqësues të pushtetit vendor, të AdZM Korçë, të shoqërisë civile, administrata e Parkut të Prespës, banorë e fermerë të zonës, nxënës të shkollave etj.

Festa nisi me grupet artistike dhe panairin e prodhimeve tradicione të zonës. Pika me e rëndësishme e këtij aktiviteti ishte konkursi i verës. Vera e re e prodhuar nga prodhuesit e zonës dhe zonave përreth, u nxorr nga fuçitë dhe u vlerësua nga një juri prej 7 vetash (me antarë nga shoqëria civile, pushteti vendor, përfaqësues të komunitetit dhe administratës së parkut). Në fund për fituesit e tre vendeve të para ndanë edhe çmime simbolike.

Rehabilitohet moli në gjirin e Shën Vasilit/PKD Karaburun-Sazan

Gjiri i Shën Vasilit, PKD "Karaburun-Sazan", 18 Dhjetor 2015 – Në kuadër të projektit "Aktivitete të qëndrueshme ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare të Mesdheut - komponenti Shqipëria", u përuruan sot punimet rehabilituese të molit në Gjirin e Shën e Vasilit në Parkun Kombëtar Detar "Karaburun-Sazan" në financuar nga INCA dhe UNDP. Tashmë ky mol i ndodhur në brëndësi të PKD "Karaburun-Sazan" do ti shërbejë akoma më mirë mjeteve lundruese turistike si dhe vetë turistëve të cilët dëshirojnë të vizitojnë këtë gji të mrekullueshëm. Të pranishëm në përurim ishin



Vijon në faqe 4

Vijon nga faqe 3 Presidenti i INCA z. Genti Kromidha, Drejtori i AKZM z. Zamir Dedej, përfaqësues të UNDP, të AdZM Vlorë si dhe të pranishëm të tjerë.

Prezantohet Plani i Turizmit dhe Biznesit për PKD Karaburun-Sazan

Parku Kombëtar Llogora, 18 Dhjetor 2015 – Në kuadër të projektit "Aktivitete të qëndrueshme ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare të Mesdheut - komponenti Shqipëria", INCA në bashkëpunim me AKZM, UNDP dhe AdZM Vlorë organizuan një seminar për prezantimin e Planit të Turizmit dhe atij të Biznesit për Parkun Kombëtar Detar "Karaburun-Sazan". Të pranishëm në takim përveç grupeve të interesit ishin edhe Presidenti i INCA z. Genti Kromidha, Drejtori i AKZM z. Zamir Dedej, përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, të AdZM Vlorë, të pushtetit vendor, të shoqërisë civile, etj.

Më herët u inaguruan edhe punimet rehabilituese të Zyrës së Informaciomit në PK Llogora.

Fushatë mjedisore ndërgjegjësuese

Peisazhi Ujor/Tokësor i mbrojtur "Lumi Buna Velipoje", Dhjetor 2015 - INCA në bashkëpunim me AKZM, AdZM Shkodër, DAR Shkodër, Qendrën Aahrus Shkodër dhe me mbështetje të IUCN dhe Cooperazione Italiana, është duke zhvilluar një fushatë ndërgjegjësuese me nxenesit e shkollave 9 vjeçare që gjenden përreth zonës.

Me nxënësit e shkollës Gjergj Vat Martini-Velipoje

Me nxënësit e shkollës Gjergj Vat Martini-Rrjolf

Qëllimi i kësaj fushate është të përmiresoje dhe të rrisë ndërgjegjësimin dhe vlerësimin e komunitetit dhe në veçanti të fëmijëve, mbi mbrojtjen e zonave të ndjeshme dhe vlerën e shërbimeve mjedisore që ofron ekosistemi në zonat e mbrojtura. Kjo do të inkurajojë komunitetin që të ndryshojë perceptimin dhe sjelljen ndaj natyrës si dhe do të nxisë frymëzimin për aktivitete me fokus ruajtjen e natyrës.

Me nxënësit e shkollës Luce Agraja-Pentar

Në këtë kuadër gjatë javës së shkuar u organizuan vizita mjedisore edukative në zonën e mbrojtur me nxënësit e shkollave 9 vjeçare të zonës. Qëllimi i këtyre vizitave ishte informimi mbi vlerat specifike të zonës dhe rëndësinë e ruajtjes dhe zhvillimit të tyre.

Me nxënësit e shkollës Pjeter Gaci-Shirq

Gjithashtu gjatë vizitave nxënësit u njohën me florën dhe faunën e zonës si dhe punën e Rangers-ave të AdZM Shkodër për ruajtjen dhe mirëmenaxhimin e zonës.

Me nxënësit e shkollës Luce Agraja-Dajc

NJOFTIME

27 Janar - Dita e Shërbimit Pyjor Shqiptar

1 - Raporti i plotë studimor rreth vlerësimit të cilësisë së studimeve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projekteve të hidrocentraleve në Evropen Juglidore.
http://d2ouvy59p0dg6k.cloudfront.net/downloads/hidro_v6_webr.pdf

2 - Rrugëtimi drejt Parisit 2015 - për integrimin e çështjeve të NK në politikat dhe dokumentet strategjike të vendit.
http://www.inca-al.org/index.php?option=com_k2&view=item&id=438:rrugetimi-drejt-parisit-2015&Itemid=133&lang=sq

3 - MEDfOR applications are NOW open for Erasmus Mundus scholarships and self-funded students, for the 2016/2017edition. Deadline: January 15th, 2016.
http://www.medfor.eu/

4 - Për të lexuar **"*Ditari i Natyrës*"** në vite…
http://www.inca-al.org/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=15&Itemid=195&lang=sq

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në ditarin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.
Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës
Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, 1001, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437
www.inca-al.org; info@inca-al.org; www.facebook.com/inca.albania